



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.28, datë 09.07.2024

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIM MAGAZINASH, SHOWROOM, ZYRA, RIKONSTRUKSION I OBJEKTEVE
EKZISTUESE, SHITESË KATI DHE SHITESË ANËSORE”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VORË

Në mbështetje të 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues, shoqëria “Kato Aromatic Albania” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Ndërtim magazinash, showroom, zyra, rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë kati dhe shtesë anësore”, me vendndodhje në Bashkinë Vorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kato Aromatic Albania” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 28.02.2020, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 26/12 / 2024